



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranverorë**

Kryesia e Kuvendit  
P-017  
Prishtinë, më 29 prill 2008, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE  
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 29 PRILL 2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq dhe Xhezair Murati;

Nga grupet parlamentare: Safete Hadergjonaj, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Bojan Stojanoviç, dhe Zylfi Merxha;  
Munguan: Lulzim Zeneli dhe Ardian Gjini;

Nga Qeveria e Kosovës: Ramë Manaj.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

**Kryesia**, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

### **R e n d d i t e:**

1. Shqyrtimi i Propozim-Rezolutës së Grupit Parlamentar të AKR-së,
2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve buxhetore të Kuvendit për tre mujorin e parë të vitit 2008,
3. Shqyrtimi i kërkesës së delegacionit të Kuvendit për lejimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë,
4. Të ndryshme.

#### **1. Shqyrtimi i Propozim-Rezolutës së Grupit Parlamentar të AKR-së**

**Kryetari** i njoftoi të pranishmit se Grupi Parlamentar i AKR-së, në pajtim me rregullat 7.23 dhe 32 të Rregullores së Punës, ka propozuar që në seancën e parë të radhës, Kuvendi të nxjerr një rezolutë kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë.

Kryetari ftoi kryetarin e Grupit Parlamentar të AKR-së ta arsyetoj propozimin.

**Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së e arsyetoi nevojën që Kuvendi ta nxjerr një rezolutë kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë. Ai shtoi se, përveç Grupit Parlamentar të AKR-së, kërkesën për nxjerrjen e Rezolutës e kanë mbështetur edhe disa deputetë të grupeve të tjera parlamentare.

Ne kemi hartuar Projekt-Rezolutën dhe jemi të gatshëm që tekstin e saj ta harmonizojmë me grupet e tjera parlamentare.

Ai kërkoi që Projekt-Rezoluta kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë të radhitet në rend dite të seancës plenare.

Kryetari hapi debatin lidhur me propozimin e Grupit Parlamentar të AKR-së.

**Naim Maloku** mbështeti propozimin e AKR-së. Ai shtoi se serbëve të Kosovës me Kushtetutën tonë u është njohur e drejta e dyshtetësisë. Ata kanë të drejtë për të votuar për zgjedhjet qendrore në Serbi, por jo edhe për zgjedhjet lokale. Ndërsa, sa i përket tekstit të Rezolutës ai duhet të ripunohet dhe të harmonizohet me grupet e tjera parlamentare.

**Slobodan Petroviq** tha se qëndrimin e Partisë Liberale është i qartë lidhur me zgjedhjet në Serbi më 11 maj të këtij viti. Për shpalljen e zgjedhjeve në Kosovë autoriteti i vetëm është UNMIK-u, të cilin ne e mbështesin plotësisht. Zgjedhjet parlamentare dhe ato lokale janë dy gjëra të ndryshme, të cilat nuk duhet t'i ngatërrojmë. Ne nuk dëshirojmë, me këtë rast, të nxjerrim përfaqësues që nuk do të kenë legjimitet. Këtyre zgjedhjeve nuk duhet kushtuar shumë rëndësi. Mbajtja e tyre në Kosovë më së shumti do t'i kushtojë vetë Serbisë. Ne mbështesim qëndrimet e Qeverisë së Kosovës dhe të bashkësisë ndërkombëtare.

**Nexhat Daci** tha se e përkrahë propozim që institucionet e Kosovës, e në këtë rast Kuvendi, duhet të kenë qëndrim lidhur me ngjarjet që po afrohen dhe se këto qëndrime duhet të jenë të koordinuara. Ndërsa, reagimet institucionale të jenë shumë më serioze se deri më tani. Teksti i rezolutës duhet të harmonizohet dhe ripunohet bashkërisht me të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare dhe të finalizohet nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Kuvendit.

**Xhezair Murati** tha se mbështet propozimin e AKR-së për nxjerrjen e Rezolutës kundër mbajtjes zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë. Ai tha se edhe në komunën e Dragashit, posaçërisht në pjesën e Gorës, po bëhen përgatitjet për mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në atë pjesë. Ai shtoi se këtë rajon, kohëve të fundit, po e vizitojnë shumë emisarë dhe flitet se po angazhojnë mjete të mëdha financiare për t'i përvetësuar qytetarët për politikën e tyre. Por, është për tu befasuar, shtoi ai, se askush nga institucionet vendore nuk reagon për këto veprime.

**Sabri Hamiti** e përkrahu propozimin që Kuvendi të dal me një qëndrim sa i përket mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Kosovës. Kuvendi e ka për obligim të veproj sipas ligjeve në fuqi, e të cilat e ndalojnë mbajtjen e këtyre zgjedhjeve në Kosovë dhe sidomos duke marrë parasysh faktin se deri me 15 qershor 2008 Kushtetuta nuk hynë në fuqi ndërsa në anët tjetër në bazë të Kornizës Kushtetuese zgjedhje në Kosovë i organizon PSSP-ja.

**Kryesia**, pasi diskutoi për propozimin e Grupit Parlamentar të AKR-së, vendosi që atë ta radhisë në rend dite të seancës plenare më 29 prill 2008, kurse teksti i Projekt-Rezolutës të harmonizohet ndërmjet grupeve parlamentare.

## **2. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve buxhetore të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2008**

**Kryesia**, me propozimin e Kryetarit, shtyu shqyrtimin e Raportit të shpenzimeve buxhetore të Kuvendit për tremujorin e parë të vitit 2008, për mbledhje tjetër të radhës.

## **3. Shqyrtimi i kërkesës së delegacionit të Kuvendit për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel**

**Kryetari** i njoftoi të pranishmit lidhur me udhëtimin zyrtarë të delegacionit të Kuvendit në Bruksel.

**Kryesia**, me propozimin e Kryetari, mori këtë

### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar në Bruksel, Belgjikë prej 5 deri më 8 maj 2008, i delegacionit të Kuvendit, në përbërje: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Slobodan Petrović, anëtarë të Kryesisë, Mehmet Hajrizi e Ismet Hajrullahu, këshilltarë të Kryetarit të Kuvendit dhe Ismet Krasniqi, sekretar i Kuvendit.
2. Shpenzimet e qëndrimit në Bruksel për delegacionin e Kuvendit i përballon organizatori, kurse shpenzimet e udhëtimit dhe mëditjet përballohen nga buxheti i Kuvendit.

#### **4. Të ndryshme**

##### **4.1 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Berat Luzha për nxjerrjen e një deklaratë kundër akuzave të Carla del Ponte, që i ka bërë ndaj UÇK-së**

**Kryetari** informoi anëtarët e Kryesisë me kërkesën e deputetit Berat Luzha, e mbështetur edhe nga 6 deputet të tjerë, që ishte e bazuar në Rregullën 23.2 të Rregullores së Punës të Kuvendit. Parashtruesi kishte propozuar që Kuvendi, në seancën e ardhshme, të nxjerr një deklaratë kundër shpifjeve të ish kryeprokurores së Tribunalit të Hagës -Carla Del Ponte.

**Kryesia**, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, vendosi që seancën ta njoftoj me kërkesën e parashtruar, ndërsa nxjerrja e Deklaratës të shtyjë për një seancë tjetër të radhës.

##### **4.2 Kërkesa e anëtarit të Kryesisë Ibrahim Gashi për lejimin e udhëtimit në Suedi**

**Kryesia**, pasi e shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

#### **P ë r f u n d i m**

Kërkesa e anëtarit të Kryesisë, Ibrahim Gashi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Suedi nuk është në pajtim me Vendimin nr. 02-2242-1/06 për udhëtime jashtë vendit.

**Kryetari** e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

E hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**